



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

### Procesverbal 4/2026

I Mbajtur në takimin e IV-të të rregullt të KK-së me datën 31.03.2026, në sallën e Kuvendit në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtares për informim.

#### Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kryetarë i Komunës Agim Aliu, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e IV-të të rregullt Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

#### Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KK-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KK-së;
4. Raporti i Punës për Vitin 2025;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për procesin e zgjedhjes së kryetarëve të këshillave lokale në fshatrat dhe zonat urbane të Komunës së Ferizajt;
6. Propozim-Vendim për plotësim ndryshimin e Vendimit me Nr. 10 i datës 30.12.2025 i plotësuar - ndryshuar me Vendimin me Nr. 26 i datës 27.02.2026;
7. Propozim - Vendim për kompensimin e Kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane për tërë territorin e Komunës së Ferizajt;
8. Propozim -Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të pjesëve të ngastrave kadastrale 3586-0, 3538-0 Z.K.Ferizaj, prona private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 1043-0 Z.K. Ferizaj, pronë e Komunës së Ferizajt;
9. Propozim -Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të pjesëve të ngastrave kadastrale 7-2, Z.K. Surqinë, prona private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 699-1 Z.K. Babush i Serbëve, pronë e Komunës së Ferizajt;
10. Propozim – Vendim për Shpallje Interes i Përgjithshëm të pjesëve të ngastrave kadastrale; 702-0,703-0, 704-0, 705-0 dhe 706-0 Z.K.Babush i Serbëve, prona private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 737-0 Z.K. Babush i Serbëve, pronë e Komunës së Ferizajt;
11. Propozim -Vendim për këmbimin e pjesës së ngastrës kadastrale 275-3, Z.K. Gërlicë e Ulët, pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 274-2 Z.K. Gërlicë e Ulët, pronë e Komunës së Ferizajt;
12. Propozim -Vendim për dhënien në shfrytëzim të ngastrës kadastrale 301-1 Z.K.Varosh;

13. Propozim -Vendim për plotësim e ndryshimit të vendimit me Nr.01.Nr.96 të datës 12.05.2017;
14. Propozim - Vendim për plotësim ndryshimin e publikimit të listës së pronave të Komunës së Ferizajt për dhënie në shfrytëzim për Vitin 2026;
15. Propozim - Vendim për miratimin e Rregullores për Ushtrimin e veprimtarisë së Transportit Publik të Udhëtarëve me Taksi;
16. Pyetje dhe kërkesa dhe
17. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës pasi e lexoi rendin e ditës së lartcekur pyeti nëse ka dikush rreth rendit të ditës dhe fjalën e mori Arian Imeri i cili pasi përshëndeti të pranishmit dhe sa i përket rendit të ditës kërkojmë mu largu pika e 6 e rendit të ditës ne e kemi rishqyrtu sipas kërkesës njëherë sa i përket kuotës gjinore dhe në atë rast përfaqësimi i subjekteve ka qenë qysh është tash dhe në bazë të dokumentit ju e shihni që nuk keni asnjë rekomandim se si me ndryshu ose cilin subjekt me ndryshu, nëse zyrtari e ka analizu këtë u dashtë me thanë që këtë subjekt duhet ta ndryshoni mirëpo nuk shkruan ashtu dhe në bazë të asaj që kemi marrë thuhet komiteti kryesohet nga kryesuesi i kuvendit dhe përbërja e tij duhet të reflektoj përfaqësim e entiteteve të subjekteve dhe mbi këtë bazë pjesë e këtij komiteti është edhe Kryesuesi i kuvendit që udhëheq seancën dhe merr pjesë në këtë komitet edhe fjala reflektim nuk është që i përshtatet ndonjë formule të sakte matematikore, edhe pse përbërja aktuale është saktë sipas formulës së KQZ, edhe zyrtari duhet te respektoj ligjin dhe jo çka aj mendon ka qenë pjesë e arsytimit kuota gjinore dhe ka qenë saktë e precizuar ajo pjesë, ndërsa te ky arsyetim nuk definohet saktë, a hyn ne kalkulim kryesuesi apo jo, dhe është obligim i ministrisë që nëse mendon ndryshe me procedu ne kuvend dhe me plotësu saktë, mirëpo jo çka mendon një zyrtar në ministri atje, nuk mundet me thanë diçka çka nuk parasheh ligji, prandaj unë mendoj që ne komitetin e kemi të themelum dhe është dashtë me thirr mbledhjen e KPF-së edhe në këtë seancë sepse ligji për vetëqeverisjen lokale i njeh vendimet e kuvendit te komunës si valide, përderisa te njëjtat nuk rishqyrtohen nga kuvendi i komunës apo shkojnë në gjykatë e ajo vendos ndryshe, pra kërkoj që të largohet kjo pikë dhe e njëjta të thirret pasi KPF-ne e kemi të formume dhe të votuar nga të gjitha subjektet politike, ju faleminderit.

Sadat Ismajli pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që kjo pikë e Gërlicës, pra 11 kërkoj që të shtyhet pasi nuk jemi të përgatitur dhe nuk e dimë çka po bahet pasi mendoj që do të ketë reagime të qytetarëve, pra kërkoj që të shtyhet për një seancë tjetër.

Brahim Osmani pasi përshëndeti të pranishmit theksoi sa i përket pikës së 6-të mendoj që tash u dashtë mi kry këto pazare si koalicion dhe mos me mbet pa kryesi të kuvendit dhe nëse edhe tash nuk ndryshohet i bjen që 4 mbledhje nuk i rishqyrtojmë pikat në KPF, mendoj që duhet mu ndryshu ju si partner të koalicionit pasi spo di a keni, megjithëse për do pika po shihet që keni e për disa si kjo po shihet që s'keni, MAPL këtu e ka cek shumë kjart që duhet të plotësohet pasi edhe këtë do ta kërkoj prap nga MAPL-ja që të shqyrtohet.

Festina Sadiku Hyseni pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që pikën e 8-të kërkoj që të hjeket ose shtyhet dhe pika 9-të pas matjes nga gjeodet pala është tërheq nga kërkesa dhe kërkoj që të hjeket.

Hatixhe Bungu Qerimi pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që as unë nuk pajtohem që të hjeket pika 6-të, pasi organi i MAPL-së është mbikëqyrës dhe po bëhen 3 muaj që po kthehet kjo pikë dhe si e tillë duhet të plotësohet dhe me dal këtu në foltore me than që mapl pe kthen pse ju ka tek një zyrtari në ministri me shkru diçka është jo në rregullt, mirëpo ky komitet duhet të shqyrtohet dhe themelohet ashtu si e parasheh ligji, dhe atë ka me kthy çdo muaj deri sa të rregullohet si duhet.

Xhavit Zariqi theksoi që sa i përket pikës së 6 unë kam vetëm një fjalë, duhet me kuptu secili anëtar i kuvendit që kjo s'është çështje e vullnetit të subjekteve politike dhe as e anëtareve të kuvendit dhe ministria e ka kthy të paligjshëm këtë vendim sa i përket përbërjes së kuvendit na mujna me shty, mirëpo prap e kem njëjtë, sa shkon kjo nuk e di, mirëpo një vendim i ministrisë kërkon që të ndryshohet dhe si kena nejt që disa muaj rrim apët, ka të bëjë me ligj, na e kem votu e kem dërgu dhe naj kanë kthy, mirëpo e hjekim prej rendit të ditës jemi pa kpf duhet ta dimë.

Arian Imeri e para ministria nuk është mbi ligjin, thuje t'i ku thotë ligji që kryesuesi nuk hyn në formulën përzgjedhëse pasi zyrtari i ministrisë nuk është gjykatë kushtetuse, sa i përket kpf, ajo është funksionale pasi ligji thotë neni 82.1 që akti komunal nuk suspendohet nëse ministria e suspendon, ajo është funksionale e sa i përket a takohemi a jo ajo shihet kur te kemi seancën e radhës.

Kryesuesi e vendos në rend të ditës rendin e ditës si e keni marrë me material ku votuan të gjithë 38.0.0.

Propozimi për hjekjen nga rendi i ditës të pikës së 6 kush është për mu hjek, votuan për mu hjek 21 anëtar, kundër 8 dhe 0 abstenim.

Propozimi nga drejtoresha për tu hjek nga rendi ditës pika 8, 9 dhe 12 nga anëtari i kuvendit dhe të gjitha këto pika u hjekën nga rendi i ditës me 23 vota për 0.0.

Kryesuesi theksoi që vazhdojmë me rendin e ditës sa i përket procesverbalit a ka vërejtje dhe pasi spati i njëjti u votua unanimisht me 40 vota.

Kryesuesi vazhdoi me pikën e 4 raportin e punës dhe ia kaloi fjalën Kryetarit të Komunës Agim Aliut.

I nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës,

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Media, shoqëri civile,

Zonja dhe zotërinj!

Jam këtu, për të prezantuar një përmbledhje të punës së qeverisjes sonë, nismave e projekteve, punëve publike që realizuam gjatë vitit 2025 për Ferizajn e ferizajasit. Jemi këtu për të prezantuar para jush – Raportin e Punës për vitin 2025 të Komunës së Ferizajt.

Viti 2025 – ndonëse ishte sfidues jo vetëm për Komunën por edhe gjithë Republikën, u shënuar me suksese të shumta, me arritje që bënë Ferizajn të ec një hap para në synimet tona të përbashkëta për një qytet funksional, të zhvilluar e të mirëqenë. Ky raport pune, është produkt i një përpjekje që nuk njih pushim, nuk njih ndalim, por qëndron gjithnjë gati, në krye të detyrës - 365 ditë të vitit, për t'i shërbyer qytetarëve, për të realizuar objektivat tona qeverisëse dhe planifikimet tona programore.

Zonja dhe zotërinj!

E kemi dëshmuar me vepra e jo fjalë, se kemi vizionin që Ferizajt i jep kahje të reja zhvillimi. E kemi dëshmuar se ëndrra për një qytet funksional, të zhvilluar, nuk është thjesht një ëndërr, dëshirë a fjalë, por vepër e prekshme çdo ditë nga qytetarët. Janë veprat për të cilat sot flasim, ato që i shërbejnë qytetarëve, ato që do t'i rezistojnë dekadave, si një dëshmi e përkushtimit dhe vizionit për të ardhmen e këtij qyteti. Në planin e infrastrukturës rrugore e shërbimeve publike, viti 2025 ishte nga më të begatët në gjithë harkun kohor të qeverisjes sonë, gati një dekadëshe. Përruam nënkalimin më të madh në historinë e Kosovës – kryeveprën infrastrukturore – Nënkalimin tek Stacioni Policor në Ferizaj, një vepër infrastrukturore që flet zëshëm për guximin, vizionin, qasjen transformuese që kemi për qytetin që duam. Po kështu, Ferizajt iu shtua edhe nga më modernët në gjithë Rajonin – Stacioni i Ri i Autobusëve, investim ky që i jep dinamikë të re zhvillimi fushës së transportit dhe ekonomisë lokale, veçanërisht duke i shtuar kësaj edhe Transportin Publik Urban që për herë të parë e bëmë realitet për ferizajasit, vitin që shkoi.

Në kuadër të investimeve madhore që ndodhën në Ferizajn e vitit 2025- u inaugurua edhe Nënstacioni i Ri i Energjisë Elektrike, projekt i nisur më 2018 – bashkëfinansim prej 7 milionë euro që është garanci e sigurisë energjetike dhe me ndikim të drejtpërdrejt në mirëfurnizimin e ekonomive familjare dhe bizneseve me energji elektrike. Gjithashtu, gjatë vitit 2025 vazhduam me punë që transformuan rrugë e zona të shumta në qytet e fshatra si rikonstruktimi me të gjithë infrastrukturën përcjellëse i rrugës “Brigada 161”, “Besim Rexhepi”, “Bedri Asllani” e “Tahir

Sinani”, rregullimi i kryqëzimit në rrugën “Driton Islami” dhe “Cen Dugolli”. Nisën punimet edhe në arterie të rëndësishme rrugore që lidhin Ferizajn me zonën rurale, si rikonstruktimi i rrugës Ferizaj-Pleshinë në bashkëpunim me Ministrinë, përfundimi i rrugës Pleshinë-Kashtanjevë, rikonstruktimi tërësor dhe zgjerimi i rrugës mbi 10 kilometërsh bashkë me infrastrukturën përcjellëse në fshatrat Babush i Ri, Prelez, Surqinë, Mirash e Cërnillë investim ky bashkë me Ministrinë, pa lënë anash edhe investimet në infrastrukturën rrugore të dhjetëra fshatrave të Ferizajt. Në pikëpamje të financave realizuam të hyra vetanake në vlerë 10,484,565.77€, kurse të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2025 ishin 7,974,306.00€, angazhim ky që dëshmon se kemi arritur ta realizojmë planin për 2,510,259.77€ më shumë në krahasim me planifikimin e të hyrave ose shprehur në përqindje kemi 31.48 % tejkalim të planifikimit.

E veçantë si në asnjë nga komunat tjera, mbetet mbështetja jonë për gratë në biznes, përmes akordimit të fondit të dedikuar për bizneset e udhëhequra nga gratë, ku dhjetëra biznese të tilla u mbështetën gjatë vitit 2025, pa lënë anash edhe investimet tjera të rëndësishme në fushën e turizmit si atraksioni turistik “Via Ferrata” dhe ura tibetiane në vargmalet e jashtëzakonshme të Jezercit, panaire e mundësi të shtuara për punësim e angazhim të punonjësve në sektorin privat, bashkëpunim me bizneset e shumta ferizajase si dhe nga diaspora e nisma të tjera në dobi të ekonomisë lokale.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit!

Zonja dhe zotërinj!

2025-ta për të gjelbërtën në Ferizaj mbetet një vit i shënuar me përplot aktivitete, projekte e nisma që i japin frymë të re qytetit e ambiente të reja për qytetarët.

Në këtë kuadër, në fushën e mjedisit dhe planifikimit hapësinor nisëm punën për hartimin e Planit të ri Zhvillimor Komunal – Kushtetutës së re Urbane, investuam në masive të reja të gjelbërta, duke shtuar me dhjetëra hektarë hapësirat e reja të gjelbërta për qytetarët, si përmes projektit të zgjerimit të Parkut të Lirisë që është kthyer në një nga zonat natyrore më të vizituarat në gjithë rajonin tonë, po kështu edhe investimet në ndërtimin e Parkut në Kodrën e Sherretëve, rikonstruktimi e rivitalizimi i hapësirave të parkut në Grykën e Neredimes, vazhdimi i punimeve në ndërtimin e dy parqeve të reja në qytet, Parku tek ish lokacioni i Kompanisë “Pastërtia” dhe

Parku tek ish lokacioni i Stacionit të Autobusëve, pa lënë anash edhe investimet tjera që bëjnë për të gjelbërtën, si rregullimi i hapësirave të reja në kurrizin e nënkalimit – tek sheshi “Ramadan Rexhepi”, parku në rrugën “Sali Çeku”, parqet e reja në Slivovë dhe Greme, hapësirat e rigjeneruara përgjatë rrugës “Gursel e Bajram Sylejmani”, shto këtu edhe nisjen e punimeve për parkun në Varosh e investime të tjera të rëndësishme për të gjelbërtën.

Në këtë kuadër, investuam edhe në blerjen e makinerive të reja për Ndërmarrjen “Ambienti” që mirëmbajtja e hapësirave publike të ndërroj cilësisht. Nga të gjitha këto investime, nisma e projekte, Ferizaj vitin që shkoi u shpall komunë kampione në Fletë notimin Mjedisor të Komunave vlerësim ky për përmbushjen e premtimeve nga platforma qeverisëse për projektet e gjelbërta.

I veçantë e me plot investime, ishte viti 2025 edhe për shëndetësinë ferizajase. Ferizaj në vitin 2025 përuroi qendrën më moderne shëndetësore në Rajon - Qendrën e Mjekësisë Familjare nr.2, projekt ky në bashkëfinancim me organizatën “Qatar Charity” që i jep një dimension të ri zhvillimi e shembulli infrastrukturës shëndetësore në shërbim të pacientëve. Po kështu, në këtë qendër lansuam edhe shërbimet e plota për pacientët si Emergjencia / 24 orë, Stomatologji / 24 orë, Barnatore doracake / 24 orë, Kujdes paliativ/ 12 orë, Laboratorë/12 orë.

Sa i përket infrastrukturës shëndetësore, po vijojnë punimet edhe në ndërtimin e objektit të ri të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare - bashkëfinancim me Ministrinë e Shëndetësisë, gjersa është në fazë të avancuar edhe projekti i ndërtimit të objektit të ri të Qendrës Shëndetësore në fshatin Koshare, duke theksuar edhe angazhimet tona tjera si në blerje e donacione të pajisjeve shëndetësore, aparatrave moderne në shërbim të pacientëve.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit!

Në planin e arsimit, Ferizaj dallon qartësisht nga komunat e tjera, shprehur kjo në dy plane – mbështetje për studentët si dhe investime në infrastrukturën shkollore. Për të 5-tin vit me radhë, si asnjë komunë tjetër e Kosovës, ndamë bursa për mijëra studentë ferizajas, për të gjithë aplikantët, pa dallim. Jo vetëm si mbështetje, por edhe si vlerësim për angazhimet e të rinjve tanë në profilet që ata kanë zgjedhur t’i studiojnë dhe për të njëjtat të kontribuojnë për shtetin e shoqërinë.

Po kështu, në planin e infrastrukturës shkollore, përruam objektin e ri të dy shkollave të mesme – Gjumnazin “Dr. Shaban Hashani” dhe Shkollën e Mesme të Mjekësisë “Elena Gjika”, përruam gjithashtu edhe shkollën e re në Talinoc të Muhaxherëve – bashkëfinancim me Ministrinë e vijuan punimet në ndërtimin e objekteve të reja shkollore si në Tërrn, shkollës në rrugën “Sali Çeku” dhe shkollës së re në Neredime - të cilën e përruam pak ditë më parë.

Gjithashtu, funksionalizuan kopshtin për fëmijë në Greme, nisëm ndërtimin e kopshtit për fëmijë në Dardani bashkë me Ministrinë dhe përruam ndjeshëm infrastrukturën përcjellëse shkollore përrmes investimit në oborret e hapësirat shkollore në dhjetëra shkolla të qytetit e fshatrave të Ferizajt.

Në fushën e bujqësisë, me mbi 10 milionë euro investime në qeverisjen tonë, mbështetëm qindra bujq e fermerë si dhe realizuan projekte të rëndësisë kapitale si përrurimi i Tregut të ri e modern të kafshëve – një projekt unik me gjithë infrastrukturën përcjellëse për këtë qëllim, përruam për herë të parë në Ferizaj, e dyta në nivel vendi – Strehimoren për Qentë Endacak vijuan me punët e angazhimet për rregullimet në projektin e ndërtimit të sillosëve dhe për rregullimin e hipodromit në mes fshatrave Prelez i Muhaxherëve dhe Papaz, përrfshirë këtu edhe mbështetjen e qindra bujqve e fermerëve përrmes skemave të subvencioneve të Drejtorisë së Bujqësisë, me mekanizëm e pajisje bujqësore, sisteme e subvencione që rrisin ndjeshëm cilësinë e prodhimtarisë dhe lehtëson punën e bujqve e fermerëve ferizajas.

Zonja dhe zotërinj!

Të nderuar anëtarë të Kuvendit!

Edhe në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, viti 2025 u shënua me projekte, ngjarje e nisma të shumta. Tashmë është nënshkruar kontrata për ndërtimin e Stadiumit të Ri Futbollistik “Ismet Shabani” në Ferizaj, me vlerë prej 17 milionë eurove dhe kapacitet prej 8,415 ulëseve – bashkëfinancim me MKRS e po kështu vijuan me projekte që shtojnë mirëmbajnë dhe shtojnë hapësirat sportive si rikonstruktimi i tribunave në Stadiumin aktual të Qytetit, rregullimi i tribunave në fushën e futbollit në Prelez të Muhaxherëve, ndërtimi i fushave të reja sportive si në Fshatin e Vjetër, Doganaj, Sojevë, Mirash, Surqinë etj, duke vënë spikamën edhe në ngjarjet kulminante sportive e kulturore, tituj të shumtë kampionësh individual e ekipor, program të pasur

artistik e kulturor, që pasuruan e i dhanë gjallëri jetës kulturore, rinore e sportive të Ferizajt në vitin 2025.

Viti 2025, siç theksova, ishte vit me shumë ngjarje, vit që skalitet suksesshëm në kalendarët e qeverisjeve të Ferizajt, andaj gjej rastin edhe përmes kësaj foltoreje, t'ju falënderoj ju, anëtarë të Kuvendit, shoqëri civile, media e të gjithë bashkëqytetarët tanë, që me mbështetjen tuaj, mundësuar një vit të begatë e sukses plotë për Ferizajn e ferizajasit.

Ju faleminderit!

VISAR

AZEMI

i nderuar Kryesues,

Të nderuar kolegë asamblistë,  
I nderuar Kryetar i Komunës,

Të dëgjova me vëmendje gjatë shpalosjes së raportit tuaj tëpunës.

E kam lexuar gjithashtu me shumë kujdes këtë raport. Jo simaterial ceremonial. Por si dokument që duhet t'i rezistojëkontrollit publik, kritikës politike dhe krahasimit me realitetine qytetit të Ferizajt.

Dhe sa më shumë që e lexon këtë raport, aq më qartë del nëpah një përfundim:

ky raport është shkruar më shumë për të krijuar përshtypjesesa për të dhënë llogari.

Është raport i mbushur me vetëlavdërim, me fjalë të bukura, me tone triumfaliste, por shumë më i varfër kur vjen puna testandardi i provës, te sinqeriteti instituci onal dhe teballafaqimi me realitetin.

Kryetar, po na flisni për Ferizajin si model, si referencë, sihistori suksesi.

Po përdorni terma si “më i madhi”, “më moderni”, “më iavancuari”.

Po cili është standardi i provës këtu?

Me çka po e krahasoni?

Me çfarë kriteri i keni matur këto vlerësime?

Një raport serioz nuk mbahet në këmbë me epitete e fjalë tëbukura.

Mbahet në këmbë me krahasim, me matje, me rezultat dhe me prova.

Këtu kemi shumë etiketa dhe shumë pak standard.

Dhe aty nis problemi i parë themelor i këtij dokumenti.

Sepse ky raport është ndërtuar mbi një logjikë që e kemi parëshpesh tek ju:

e paraqet nisjen si përfundim, kontratën si rezultat, procesin sisukses dhe reklamën si punë të kryer.

Nëse një projekt ka nisur, del sukses.

Nëse një kontratë është nënshkruar, del sukses.

Nëse punimet janë në gjysmë, del sukses.

Nëse një objekt është inauguruar me ceremoni, del sukses.

Pra, ky raport nuk bën dallim të ndershëm mes asaj që është nisur, asaj që është në proces dhe asaj që është realisht e përfunduar.

Dhe ky është mashtrimi i parë politik i këtij dokumenti.

Qytetari do me ditë:

çka është kryer,  
çka ka mbetur pa  
pse ka mbetur pa  
sa ka kushtuar,

u kryer,  
u kryer,

dhe kush përgjigjet për dështimet e punët të cilat nuk janë kryer.

Dhe aty ku kjo do të duhej të ishte më e qartë, aty raportibëhet më i mangët.

Po ashtu, raporti mbetet i mangët edhe në disa fusha ku qytetarët presin më shumë qartësi dhe më shumë hollësi.

Kjo vlen sidomos për Drejtorinë e Urbanizmit, ku mungon njëpasqyrë më e plotë për zhvillimet konkrete gjatë vitit, përfshirë edhe trajtimin e lejeve ndërtimore sipas kategorive përkatëse.

Në një sektor kaq të ndjeshëm për qytetin, raportimi do të duhej të ishte më i plotë dhe më i detajuar.

Por hendeku më i madh mes raportit dhe realitetit del te vetëjeta e qytetit gjatë vitit 2025.

Dhe kur futesh te pjesa teknike e këtij raporti, e vërteta bëhet edhe më e sikletshme për juve.

Për nënkalimin që në hyrje e quani “kryevepërinfrastrukturore” dhe e shisni si sukses madhor të përfunduar, vetë Drejtoria e Infrastrukturës thotë se janë punuar mbi 80% e vlerës së punimeve, se nënkalimi është lëshuar përpërdorim, por kanë mbetur për finalizim pllakat në plato, mbjellja e drunjve dekorativë dhe rregullimi i hapësirave gjelbëruese.

Pra, edhe projekti juaj simbol nuk del i mbyllur ashtu siç e shisni në hyrje.

Për më tepër, te Qendra Multifunktionale, raporti thotë qartëse në fund të vitit janë realizuar vetëm mbi 20% të punimeve.

Me fjalë të tjera:

ju e keni kthyer raportin në një tekst ku edhe projekti gjysmë ikryer, edhe projekti në nisje, edhe projekti vetëm me kontratë, futen në të njëjtin thes me punët e përfunduara.

Prandaj pyetja ime është shumë e thjeshtë:

Sa nga këto që i quani arritje të vitit 2025 janë realisht të përfunduara, të pranuar teknikisht dhe të mbyllur financiarisht, e sa janë vetëm në proces, ose vetëm në letër?

QMF 2 u hap me pompozitet si qendër me orar 24-orësh.

U paraqit si sukses i madh.

U shit si standard i ri i shërbimit.

Por më pas orari u reduktua.

Qytetarët u kufizuan në marrjen e shërbimeve mjekësore.

Kjo është politika e fasadës:

premtimi i madh në ditën e hapjes,  
realiteti më i vogël më pas.

Pastaj, tentimet për ndërtime te Parku “Liria” janë rast tjetër.

U ndalën si rezultat i protestave.

U ngritën pikëpyetje serioze për mënyrën si po trajtohej ai proces.

Një raport i ndershëm do ta trajtonte këtë si rast politik dheinstitucional që prodhoi krizë besimi.

Do

ta shpjegonte.

Do ta pranonte.

Por jo.

Raporti e zbut,

e kalon ose e anashkalon, sepse ky dokument është shkruar për të ruajtur narrativën,  
jo për të treguar tëvërtetën.

Transporti urban gjatë vitit 2025 është shoqëruar me problemetë vazhdueshme,  
me mungesë të infrastrukturës përcjellëse,  
me mungesë të pritoreve për qytetarët dhe me pakënaqësi tëqarta.

Qytetarit nuk i intereson çka shkruan raporti.

Atij i intereson a

e

ka autobusin. A i vjen me orar.

A

e

ka stacionin.

A e ka shërbimin.

Dhe në këtë pikë, realiteti ka qenë shumë më i dobët sesagjuha e raportit.

Ju jeni në dijeni për këto pakënaqësi, por nuk keni dashur t'ipërmendni.

Çmimet e çerdheve janë një tjetër shembull i së njëjtëslogjikë.

Vendimi u

mor.

Reagimi publik shpërtheu.

Dhe komuna u tërhoq.

Kjo tregon jo qeverisje të mençur, por qeverisje që e  
teston kufirin e durimit të qytetarëve dhe tërhiqet vetëm kur has nërezistencë.

Edhe kjo është pjesë e vitit 2025.

Edhe kjo duhej pasqyruar me ndershmëri.

Në shëndetësi, raporti bëhet i kujdesshëm pikërisht aty kuduhet të ishte i qartë.

Gjatë vitit ka pasur akuza publike dhe dyshime për konkursetë dyshimta në QKMF, përfshirë pre  
tendime për punësimefamiljare.

Ka pasur punësime në kohë fushate. 300 mjek e infermier ikeni marrë në punë në kohë fushate.

Ka pasur reagime publike edhe nga asambleistët tanë këtu nëkëtë sallë.

Ka pasur çështje rreth konkursit për 21 punëtorë shëndetësorë, i cili është anuluar nga Thesari.

Ka pasur reagime edhe për QMF Softaj, për çështjen e aparaturave dhe për pakënaqësitë qytetare

Unë nuk po i them këto si verdikte.

Po i them si çështje publike që kanë ekzistuar dhe që njëraport i punës nuk ka të drejtë t'i trajtojë  
sikur nuk kanëndodhur fare.

Problemi i raportit është se aty ku ka siklet politik, hesht.

Aty ku ka pasur ceremoni, zgjatet.

E njëjta gjë vlen edhe për konkurset për zyrtarë të gjeodezisë, ku ka pasur dyshime për mungesë profesionalizmi nëkomisionet e rekrutimit.

Kur

ka dyshime publike për mënyrën si punësohen njerëzit, përgjegjësia e pushtetit nuk është heshtja.

Është sqarimi.

Në arsim, raporti do të duhej të ndalej bukur gjatë.

Sepse aty nuk flitet për asfalt e beton.

Aty flitet për të ardhmen e fëmijëve tanë.

Dhe nëse rezultatet e testit të arritshmërisë janë shqetësuese, nëse asnjë shkollë nuk arrin mbi 50 % kalueshmëri, atëherë kjonuk është sfidë rutinë.

Kjo është alarm.

Kur	“Ahmet	Hoxha” është 40%,
“Dy Dëshmorët”		31.78%,
“Liman Rekaj”		33.50%,

kur në maturë “Faik Konica” ka vetëm 33.57% kalueshmëridhe “Zenel Hajdini” vetëm 18.46%, atëherë një raport serioz nuk mund ta trajtojë këtë sikur asgjës’ka ndodhur.

Duhet me

u ndalë.

Me

e analizu.

Me tregu ku ka dështuar sistemi.

Me dhënë plan korigjues.

Me marrë përgjegjësi.

Raporti juaj nuk e bën këtë.

E kalon, sepse e ka më me rëndësi imazhin e pushtetit sesa tëvërtetën e arsimit.

Dhe kur kësaj i shtohet edhe gjendja e rëndë e infrastrukturës shkollës në Varosh dhe probleme t infrastrukturore nëshkolla të tjera, bëhet edhe më e qartë se raporti nuk e pasqyron gjendjen reale.

Pastaj vijnë shifrat.

Dhe pikërisht aty raporti fillon të rrëzohet nga vetvetja.

Kur vetë raporti juaj thotë se komuna ka pasur 842 padi, qindra seanca, ankesa dhe prapësime, atëherë nuk kemi tëbëjmë me një administratë model.

Kemi të bëjmë me një administratë që diku po prodhonkonflikt serioz juridik.

Kjo nuk është veç një statistikë.

Kjo është pasqyrë e një sistemi që ka probleme reale.

Dhe problemi është se raporti i jep numrat, por nuk guxon tëjapë diagnozën:

nuk na thotë cilat drejtori i prodhojnë këto konteste,

nuk na thotë natyrën e

tyre,

nuk na thotë koston e mundshme për qytetarët.

Na jep pasojën, por na e fsheh shkakun.

Pra, 842 padi nuk janë shenjë e një komune të fortë.

Janë shenjë e një administrate që diku po prodhon padrejtësi, konflikt ose keqmenaxhim.

Pastaj shkojmë te financat.

Edhe aty raporti është ndërtuar për të impresionuar nësipërfaqe dhe për të fshehur dobësinë në th elb.

Raporti thotë se të hyrat vetanake janë realizuar në 10,484,565.77 euro kundrejt planifikimit prej 7,974,306 euro, pra 125.84% realizim.

Në lexim të parë kjo tingëllon si sukses i madh.

Por kur e lexon tabelën e detajuar, del e kundërta:

tatimi në pronë, që është baza më e qëndrueshme dhe më serioze e administrimit fiskal lokal, është realizuar vetëm 80.48% të planit.

Ndërkohë taksa për leje ndërtimi ka shpërthyer në 242.16% të planit.

Pra “suksesi fiskal” që po

e shisni si performancë të madhe administrative, në të vërtetë mbështetet fuqishëm te ndërtimi, ndërsa baza e qëndrueshme fiskale mbetet nën plan.

Me fjalë të tjera, ju po na shisni si sukses të administratës diçka që mund të jetë thjesht interes i ndërtimit, jo performancë e mire administrative.

Këto nuk janë interpretimet e mija.

Këto janë shifrat e raportit tuaj.

Prandaj po ju pyes:

Si mund ta quani sukses të pastër fiskal një vit ku tatimi në pronë dështon ta arrijë planin, ndërsa bilanci shpëtohet ngalejet e ndërtimit?

Sepse stabiliteti fiskal nuk matet me një total të bukur në fund të tabelës.

Matet me strukturën e atij totalit.

Kur auditimi i brendshëm jep 13 rekomandime, dhe vetëm 1 është zbatuar plotësisht, ndërsa të tjerat janë në proces ose të pazbatuara, atëherë s’ka vend për vetëlavdërim.

Për më tepër,

as nuk bëhet e qartë publikisht se cilat janë ato rekomandime dhe mbi çfarë gjetjesh konkrete janë bazuar.

Pra kemi auditim, por jo transparencë të plotë mbi auditimin.

Kemi rekomandime, por jo disiplinë në zbatim.

Dhe pikërisht kjo e rrëzon mitin e administratës perfekte që përpiqet të shesë ky raport.

Kur flasim për transparencën, hajde tit hemi gjërat ashtu sic janë:

Ferizaji nuk mund të jetojë vetëm me sloganin e transparencës.

Sepse vetë raporti pranon probleme serioze me dokumentet gjatë bartjes nga ueb-faqja e vjetër në të rene.

Dhe kur një pushtet flet shumë për transparencë, por vetë pranon mungesë të dokumenteve, atëherë bie e gjithë fasada e vetëlavdërimit.

Transparenca nuk është fjalë për konferencë.

Transparenca është dokument, qasje, vazhdimësi dhe gatishmëri për ta treguar edhe atë që nuk të konvenon.

Po ashtu, nuk mund të quhet vit suksesi kur disa projekte të planifikuara për vitin 2025 nuk kanë filluar fare:

tregu i gjelbër,  
shtëpia e pensionistëve,  
qendra rehabilituese për përdoruesit e substancave narkotike,  
fusha sportive në Dardani.

Dhe në anën tjetër na servohen me pompozitet projekte si Qendra Multifunktionale në Ferizaj me 3.3 milionë euro, ndërsa progresi real mbetet shumë më poshtë zhurmës politike që i bëhet.

Edhe këtu raporti zgjedh të reklamojë më shumë sesa të sqarojë.

Pra, z. Kryetar, problemi i këtij raporti nuk është se ka pak tekst.

Problemi është se ka shumë tekst për t'u dukur mirë dheshumë pak guxim për të treguar të vërtetën.

Ky raport është i dobët sepse:

e fryn diçka që veç sa ka fillu,  
e zbukuron të zakonshmen,  
e fsheh konfliktin,  
e zbut dështimin,  
dhe e shmang përgjegjësinë.

Ky raport flet gjatë për atë që ju ndihmon me u dukë mirëpolitikisht, dhe flet pak ose aspak për atë që ju dëmton politikisht.

Por kuvendi komunal nuk është vend për me lexu vetë lavdërime.

Kuvendi komunal është vend për me dhanë llogari.

Qytetarëve u intereson:

a funksionojnë QMF-të siç janë premtuar.

a janë konkurset të pastra e transparente.

a funksionon transporti urban.

a janë hapësirat publike parqe apo beton.

a po mësojnë fëmijët apo po dështojnë.

a ka transparencë reale apo vetëm propagandë.

a përfundojnë projektet, jo vetëm a fotografohen punimet e nisura.

Pra,

ju nuk po qeverisni me të dhëna që i rezistojnë kontrollit.

Po qeverisni me tregime që synojnë ta zëvendësojnë kontrollin.

Dhe kur narrativa bëhet më e madhe se realiteti, raporti ipunës nuk është më pasqyrë e qeverisjes.

Bëhet mbulesë e saj.

Faleminderit.

BRAHIM OSMANI Te nderuar qytetar,

Ky raport pune ka shume te paverteta dhe shume kunderthenie brenda vetes.

Kryetari i tanishem, gjate cdo takimi me qytetar, u thote atyre se ne si qytet jemi duke u sabotuar nga qeveria e Albin Kurtit, kurse ne kete raport, ne shumicen e projekteve, vete e cek se jane pune ne bashkfinancim me qeverine. Kur them bashkfinancim, e keni te qarte: 10% komuna, 90% qeveria Kurti. Ama shiritin ose e pret kryetari, ose kur ka zgjedhje; sikurse ne nje projekt (salle sporti), ai nuk e peruron fare, qe mos te marre ndonje poen politik qeveria Kurti.

Kemi edhe kunderthenie te llojit tjetër, si p.sh.: kemi nisur projektin e transportit publik, per te cilin kemi thene se po behet per zgjedhje, sepse tani ai nuk funksionon. I njejt, menjehere pas zgjedhjeve, eshte nderprere dhe nuk dihet kur do te filloje, pervec nese ka zgjedhje prape.

Edhe nje gje qe per cudi nuk e gjejme kurre ne raport jane ndermarrjet publike komunale. Tri jane, te tria jane me humbje, e per me teper te gjitha te mbushura me punesime familjare dhe njerez jokompetent, sic po i degjojme ne videoincizime duke share e kercenuar punetoret me shprehje nga me teuletat, te cilat jam i sigurt se asnjeri prej jush nuk do t'i toleronte per asnje anetar te familjes.

Mos mendoni se kemi harruar qe, duke pasur kompani publike per pastrimin e qytetit, ju keni ndare 1.5 milion euro ne vitin 2024 per nje kompani private qe te beje pastrimin e rrugeve te caktuara. Keto para ju kane sherbyer vetes suaj, dhe heret a vone do te jepni llogari para ligjit per kete pune.

Te infrastruktura, do t'ju lutesha qe kushdo qe e vozit veturen e kryetarit, te vendose ndonje dite te kaloje nga rruga Xheve Lladrovci, e cila mban nje emer te shenuar ne histori, por qe ju e keni lene ne harrese, duke ua veshtiresuar jeten banoreve qe e frekuentojne. Ka edhe shume rruge te tjera neper lagje qe jane ne gjendje te mjerueshme, perfshire edhe rruget qe nuk kane as 6 muaj qe jane ndertuar dhe kane filluar te demtohen.

Te Drejtoria e kultures, keni thene se jeni ne bashkfinancim me Ministrine e Kultures. Une kam nje pyetje: sa para keni ndare si komune per stadiumin? Pse e quani bashkfinancim kur asnje cent nuk eshte ndare nga komuna?

Te shendetesia, keni shkruar 42 faqe, por nuk e keni permendur askund numrin e sakte te pacienteve qe gruaja e drejtorit i referon te burri i saj ne kliniken private. Duam te dime si po ju shkon puna dhe a po arrijne financiarisht, duke shfrytezuar institucionin publik per te ardhurat e tyre familjare.

Kjo ishte sarkazem. Perndryshe, me pak karakter, i njejt do te duhej te ishte shkarkuar. Mos te harrojme faktin se per nje vend pune ne universitet kishte hequr dore nga kombesia.

Ky raport per fushen e shendetesise me se paku eshte raport pune. Ngjan me shume si pershkrim detyrash dhe obligimesh sesa tregon se cfare eshte bere realisht. Kur nuk ka cfare te tregohet, faqet mbushen me fjale per te fshehur deshtimin, sepse nuk mund te permendet as edhe nje QKMF, AMF apo QMF qe funksionon ne gjendje te rregullt.

Te drejtoria e bujqesise, raporti thote se jane paguar te gjitha subvencionet. Une, duke ardhur ne kuvend, fola me disa bujq, te cilet me thane se pagesat per qumesht nuk i kane marre ende. Madje, njeri beri shaka duke thene se u eshte sugjeruar ta shnderrojne qumeshtin ne djath, pasi fitimi eshte me i madh — por pa treg per shitje, secili le te gjeje zgjidhje vete.

Sa i perket raportit te Institutit GAP per vitin 2024, keni harruar se jeni nder kryetaret me nivelin me te ulet te mbajtjes se premtimeve zgjedhore.

Per ta permbledhur ate qe raporti nuk e thote:

- Nuk keni ndertuar as edhe nje qerdhe, nderkohe qe cmimi ne qerdhet private ka arritur ne 150 euro.
- Keni deshtuar projektin e trafikut urban dhe po i detyroni qytetaret te bejne ecje te gjata per te arritur ne stacionin e ri te autobuseve.
- Keni deshtuar ne mirembajtjen e pastertise publike; shumica e lagjeve jane te lena pas dore.
- Keni nenshkruar kontrata si ajo me Kosova Med dhe keni larguar 300 punetore, pa asnje sqarim.

Skandale ne ndermarrjen “Pastertia”.

Skandale ne shendetesi.

Shtepia e pensionisteve.

Arian Imeri - Te nderuar, sot po shqyrtojme raportin e punes se ekzekutivit komunal per Vitin 2025, një dokument i rendësishëm që pasqyron jo vetem aktivitetet, por edhe angazhimin dhe pergjegjesin institucionale ndaj qytetareve të Ferizajt.

Per raportin e punes eshte krejt normale qe ekzekutivi me prezentu punen e tyre secili per drejtorin e vet, njeherit me diskutu per ndonje vrejte qe ngriten nga antaret e kuvendit, mirpo qasja e opozites, menyra se si mundohen me minimizu punen e ekzekutivit, njeherit mi dhane konotacion te keq te gjitha puneve qe jane kry, po na detyron patjeter mu angazhu edhe ne si perfaqesues te qytetareve sepse po krijohet pershtypja sikur nuk jetojme ne te njejtin qytet.

Këta si duket po harrojne qe Viti 2025 ka qenë vit zgjedhore dhe gati në fund të vitit në Tetor qytetaret e kane dhene vlersimin e tyre rreth qeverisjes komunale ne Ferizaj. Nese kanë harru cka eshte punu ne vitet tjera, te pakten punet e vitit 2025 i kane pas te freskta sepse edhe shumica e puneve jane kry para zgjedhjeve, prandaj vlersimi i tyre me fjalimet e juve ska kurgja te perbashket.

Me ju degju juve duket sikur nuk eshte punu asgje ne komunen tone ose cdo gje eshte bere keq, mirpo qytetaret gjate vitit 2025 kane marr pjese ne perurimin e nenkalimit te Stacioni i Policis, kane perdore Stacionin me modern ne rajone te Autobusve, per here te pare ne historine e qytetit kane shfrytezuar trafikun urbane, kane shfrytezuar hapsira te reja te Parku Liria, ku kemi ndertuar hapsira te reja sportive, pajisje fitnesi, kënde lojnash dhe amfiteatër, pastaj kanë parë fillimin e punëve të parqeve te lokacioni i ish “Stacionit të autobusëve” dhe ish KRM “Pastertia”, vazhdimin

e ndertimit te Parku i Sherreteve, pastaj kanë filluar shfrytëzimin e qendrës me moderne në rajon te QMF2 ne rrugen “Remzi Hoxha” bile kjo është peruru pas zgjedhjeve.

Ne fushen e bujqësisë, bujqit kane perfitu mbi 10 milion euro investime, plus mbeshtetje të ndryshme për qindra bujqe te cilet edhe keta e kane dhene vlersimin e tyre. Pastaj kete vit kemi peruruar edhe tregun e kafsheve nje objekt modern gjithashtu.

Ne fushen e kultures dhe sportit eshte nenshkruar kontrata per ndertimin e stadiumit dhe fal angazhimit te komunes se ferizajit sot e kemi stadiumin qe do te ndertohet ne qytet, perndryshe ka pase tendenca serioze mu bart ne fshatin Sazli, qe kish qene ma keq se mos mu ndertu fare, sepse kur nuk ish ndertu kishim pas shpresa qe ndertohet ndonjehere por nese ish ndertu ne Sazli edhe nuk kishim perfitu project tjetet kur me, edhe ky kish me qene jo funksional.

Ne fushen e Arsimit 1500 student kane perfitu bursa, kemi peruru dy shkolla te reja te mesme ne qytet.

Ne fushen e financave, nuk e di si qenderojne organizatat tjera bugjetore ne Kosove mirpo per cdo organizat bugjetore qe shfrytezon mjetet financiare 99.93% sa jane shpenzimet e bugjetit ne komunen e ferizajit, pastaj realizim te te hyrave mbi 2 milion nga ato qe jane planifikuar apo mbi 25% nuk e besoj qe mundet mi arrit ndonje organizat apo jane shume shume pak prej tyre.

Si mundet me thane dikush qe nuk eshte punu ne nje komune ku jane realizu ujesjelles 21,828 metra gjatesi, kanalizim 8,928 metra, kanalizim atmosferik 15,190 metra, asfalt 414,396 m2, trotuar 6,550 metra gjatesi, shteg te bicikletave 2,194 metra. Krejt keto vetem ne drejtorin e infrastruktures dhe vetem gjate vitit 2025 shifrat i keni ne raport nese mundeni mi kontestu folni ketu e keni drejtorin e infrastruktures.

Me bje ne cdo raport, cdo vit mi permend hapjen e bizneseve te reja, po une e marr si nje indikator shume me rendesi, sepse pa nje zhvillim te komunes ne pergjithesi, pa nje klim te mire te berit biznes, pa perkrahje komunale, pa projekte zhvillimore nuk ka mundesi cdo vit mu rrit numri i bizneseve, nga 71 biznese prodhuese ne vitin 2024 kete vit jane hap 209 biznese te reja prodhuese nga gjithesej 1023 biznese ne total ne vitin 2024 kete vit jane hapur 1087 biznese. Nuk ndodhin rasishte keto gjera, sepse mu kane ndodhin ne secilen komune, plus, ne kete kohe, kur kemi nje qeveri qendrore, qe nuk le gje pa ba kunder bizneseve, e sidomos kunder bizneseve te komunes tone. Mbi 10 milion euro vetem denime te ATK-se kane pesu bizneset e komunes se Ferizajit, paramendo sa biznese shtes kishim mundur mi pas edhe rrjedhimishte edhe sa vende te reja te punes sikur te ish kane nje qasje tjeter nga qeveria qendrore.

Ka kritika rreth kontratave me sherbime mjekesore dhe te arsimit, me nje qeveri te pergjegjeshme qendrore, fillimishte i kish marr obligimet qe i takojne mi pagu per kontraten kolektive dhe me dhjetra miljona qe jemi tu pagu, i kishim rrit nivelin e sherbimeve por edhe nje qeveri e pergjegjeshme kish leju me rrit numrin e punetoreve shendetesore dhe puntoreve te arsimit aq sa i takojne komunes se ferizajit sipas regjistrimit te popullsisë dhe nuk kish pas nevoj per kontrata te veçanta per keto sherbime.

Qeveria komunale nuk mundet mi lane qytetaret me vujt per sherbime mjekesore ose me vdek dikush pse qeveria qendrore don mi denu qytetaret e ferizajit. Keto kontrata jane zgjidhje e zorit

qe Komuna e Ferizajit e bene vetem me qen afer qytetareve perndryshe pa keto kontrata po shihet qe mbyllen disa qendra mjeksore ne fshatra, pastaj QKMF 2 nuk mundet me ofru sherbime 24 ore por edhe shume sherbime tjera reduktohen te cilat ne raste te caktuara mund te jen fatale per qytetaret.

Se sa eshte punu ne kete drejtori ju tregon raporti, lexone, kemi 207,235 vetem vizita mjeksore ndersa numri i pergjithshem i sherbimeve mjeksore eshte mbi 600 mije sherbime. Pra qytetare te ndryshem, nga njeher apo dikush disa here kane marr mbi 600 mije here sherbime mjeksore, keto sherbime jane ofru edhe fal ketyre kontratave qe perkunder problemeve financiare qe po krijohen nga qeveria qendrore prap fal qeveris komunale dhe ketyre puntoreve shendetesore kemi arrit me ofru keto sherbime qe per shume qytetare mungesa e tyre ka mujt me gene fatale.

Prandaj nuk duhet me ju hup meritat krejt puntoreve shendetesore, e sidomos edhe ketyre me kontratat me operator te jashtem te cilet kane arrit me ju pergjegje nevojave te qytetareve ne keto Shifra.

Pra, keto cka une prezentova krejt jane ne raportin e punes te vitit 2025, edhe ju i keni pa edhe i keni lexu, per cdo shifer qe kam permend nese mundeni me me kontestu urdheroni une jam ketu por edhe drejtoret jane ketu, prandaj mendoj qe duhet te jemi real, ka gjithemone hapsire per mu punu ma shume, na edhe vet i permendem qe kemi pas probleme financiare qe nese kishim pas mbeshtetjen e duhur kishim punu shume ma shume.

Mirpo ne nje komune qe eshte shembull ne krejt kosoven me thane qe nuk eshte bere asgje, nuk shkon, se pastaj cka me thane per ato komunat tjera i bje qe skan punu hiq ose mshel kane qen krejt.

Xhevat Sallahu pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që sa i përket raportit të shëndetësia psh në fshatin Dardani e kemi pas një amf e kemi pas një mjek që ka qenë në sistem të pagave dhe një motër medicinale ndërsa mjeku që del në pension e që ka qenë në sistem të pagave dhe vjen një mjek që sështë në sistem kjo është problem i keqmenagjimit dhe kjo më herët ska ndodhë, edhe te puntort teknik që dalin në pension dhe në vend të tyre të punësohen militant, kjo sban. Juve edhe 100 vende të punës apet kena me pas problem psh në komunë i ki 4 vetë veç te pagesa me kqyr cili pe ban pagesën i ki sociolog napër shkolla hiq pa nevoje në ato parafillore naper disa vende, pse mjeku që ka qenë në sistem të pagës me ardhe dikush me kosovamed, në disa fshatra amf punojnë 24 orë psh në pozhoran ndërsa në qendër të Ferizajt punon me ndrrime qendra e mjeksis familjare ska ma keq edhe këto janë fakte hajde në vend ngjarje i sheh kto çka po them.

Erëza Hashani

Sot po diskutojmë për Raportin e punës për Vitin 2025. Dhe sinqerisht, mendoj që është shumë me rëndësi që këtë raport ta trajtojmë me seriozitet dhe pa paragjykime politike.

Dhe kur e lexojmë këtë raport me vëmendje, e shohim shumë qartë që pas tij qëndrojnë punë konkrete.

Nëse ndalemi vetëm te financat, që janë baza e çdo zhvillimi, shohim rezultate që nuk mund të injorohen. Menaxhim më i mirë, angazhim më i madh dhe seriozitet në punë duket qartë në çdo detaj.

Po ashtu, shpenzimi i buxhetit në nivel të plotë tregon diçka shumë të rëndësishme, që paratë e qytetarëve nuk kanë mbetur në letër, por janë kthyer në projekte dhe investime konkrete. Për më tepër, ka filluar hartimi i Planit Zhvillimor Komunal 2025–2033, një dokument që do ta përcaktojë drejtimin e zhvillimit të Ferizajt për vitet në vijim.

Në aspektin e projekteve mjedisore dhe hapësirave publike, kemi investime konkrete: Parku “Liria”, Kodra e Sherretëve, parqet e reja dhe mbjellja e drunjëve. Këto nuk janë vetëm projekte, janë investime në cilësinë e jetës.

Në arsim, përkundër sfidave që i dimë të gjithë, është arritur të mbahet stabiliteti i procesit mësimor, janë përmirësuar kushtet në shkolla, janë mbështetur nxënësit dhe janë ndarë bursa për studentët.

Dhe kur i shtojmë këtu edhe projektet madhore që janë realizuar gjatë vitit 2025, nga infrastruktura, transporti publik, investimet në shëndetësi, bujqësi e sport, atëherë është e vështirë të thuhet që nuk është punuar.

Prandaj, sot unë e shoh këtë raport si një pasqyrë reale të një pune që është bërë, me përkushtim dhe me rezultate konkrete.

Faleminderit!

Arian Imeri masi ma përmendi emrin d.m.th edhe përfaqësuesit i qeveris qendrore unë kam veç një kërkesë apo pyetje pse nuk rritet numri i punëtorëve varësisht me rritjen e numrit të banorëve pasi që Ferizajt ka qenë e 7 tash është e 3 pse spo kërkoni me u rrit nr i mjekve apo puntorve shëndetësor, ka qenë kërkesë e ministris së shëndetësis dhe ministri i financave që vjen nga qyteti ynë e ka refuzu.

Lumnije Morina pasi përshëneti të pranishmit theksoi që Raporti i punës për Vitin 2025 nuk është thjeshtë një dokument formal ai është dëshmi e qytetarve tanë që tregojnë çdo ditë, është pasqyrë e një pune konkrete e një vizioni të kuartit e një përkushtimi të jashtzakonshëm, mendoj që ky raport nuk i shërben vetëm të tashmës por një raport që do t'i shërbej edhe gjeneratave ta ardhme për transformimin e jashtzakonshëm vetëm brenda një viti për qytetin.

Përkundër përpjekjeve për këtë mostransformim të pozitës në nivel qendror faktet flasin vetë, investimet në infrastruktur e me theks të veçantë në arsim, kulturë, sport avanismi në mbrojtje të mjedisit e zhvillimi në shëndetësi bujqsi janë dëshmi të kuarta të një pune serioze dhe të përgjegjshme.

Këto rezultate janë dëshmi e kuart që s'kemi patur premtime boshe të kryetarit, por janë rezultat i një pune konkrete që kanë prodhu këto rezultate e qe janë të prekshme e të matshme të cilat çdo qytetar mund ti sheh.

Të nderuar anëtar kuvendi dhe ju qytetar vlersimi për këto arritje dhe këtë zhvillim po e bëjnë edhe të tjerët prandaj mendoj që kemi arsye të mburremi e të cilat e përmirsojnë dhe e bëjnë më të mirë jetën e qytetarve.

U fol këtu edhe për standardet e vlerësimit të Kryetarit të komunës dhe mendoj që komuna e Ferizajt është kampion sa i përket transparencës 2025 po ashtu u rendit e para për komunat e mdha për menagjimin e buxhetit, dhe me than të drejtën gjykimin më të drejt e kanë dhanë qytetart e Ferizajt edhe pse sa i përket punës gjat vitit 2025 ata kanë vlersu punën angazhimin dhe i kanë dhënë kryetarit tonë besimin për me vazhdu projektet ju falemnderit shumë.

Brahim Osmani unë veç po ja përmeni Arianit disa projekte që janë bashkëfinancim me komunën, e që kapin vlerën mbi 80 milion: asfaltimet e rrugëve Varosh-Gërlicë, Pleshine-Kashtanjeve, Jezerc, zgjerimi i kyqjes në rrugën "Arbër Gjaferi", asfaltimi në fsh.Zllatar, Prelez i Jerlive-Kosinë, Babush i ri Cërnilë Mirash, komogllave edhe shumë proekte tjera që ky kryetar i ka shti në këtë raport të qerdheve, ju jeni komuna e fundit që e keni qu projektin e qkmfs tju ba presion ministri.

Arian Imeri të gjitha këto projekte janë të iniciaua më herët dhe pytja ime ishte shumë e kjart si ka mundësi që ministri i shëndetësisë ka kërku mu rrit numri për Ferizaj dhe ministri i financave ska pranu veç në këtë pytje a mundësh mu përgjigj.

Xhevat Sallahu sa ju përket kësaj na prej 2013 kur jamë anëtar i kuvendit dhe ju thash na e kem pas një mjek në sistem të pagave ku e keni qu atë vend ku i keni qu 8 puntorë teknik ty ministria edhe 100 vende me ti shtu mrena vitit ka me pas mungese.

Brahim Osmani po i përgjigjna veç pak qysh ka mundësi që një puntorë nuk shkon në vend të punës 1 vjet tu e ditë që s'ja nxen venin kërkush, projektet që i ke qu janë tu bashkfinancu, është në procedure edhe spitali, kryesuesi theksoi që rrini në temë.

Sadat Ismajli pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që më vjen mirë që se keni potencu që gjithmonë thuni na ka ardhë kopy past, d.m.th po shihet në raport paska ndryshim sa i përket Drejtorisë së infrastrukturës u përmend, desha të përmendi që komunat në përgjithësi, e Komunën e Ferizajt në veçanti e penalizon kontrata kolektive që nuk është fare përgjegjsi e komunës, ndërsa tek Drejtoria e arsimit, në 14 shkolla u investu dhe kjo është një punë jashtëzakonisht e madhe, falemnderit egzekutivit për punën dhe besoj që do ta vazhdojnë këtë punë.

Vanese Sadriu Topojani pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit theksoi që dëgjova disa prej jush avokata të ministrisë apo qeverisë së vv, mirëpo ne sot po diskutojmë një raport që mbeshteten më shumë në përceptime sesa në realitet, raporti i punës për Vitin 2025 dëshmon kjart se në udhëheqjen e kryetarit komuna ka ec përpara në hapa të suksesshëm, projekte në infrastrukturë, arsim dhë përmisimi në shërbime publike nuk janë fjalë po janë punë të kryera që qytetarët i shohin dhe i jetësojnë çdo ditë, është e habitshme se si çdo progres mundohet të minimizohet, ndërsa çdo sfid zmadhohet, kjo nuk është qasje distruktive, mirëpo politikë e gabuar.

S'jemi për të bë spektakël politik, mirëpo për mi përfaqësu qytetart dhe ata s'masin me fjalë por me rezultate. Dhe është normale që çdo herë ka vend për përmirësim, mirëpo është jo e drejt të

mohotet puna, ky raport është dëshmi e punës së ndershme dhe këtë se them vetëm unë po e kanë thënë edhe qytetart në Vitin 2025.

Sebahate Ajeti pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që sa i përket të hyrave të tatimit në pronë u përmend paraprakisht është e vërtet që nuk është realizu 100% , mirëpo niveli i inaksimit ka qenë i knaqshëm dhe normalisht që ulja e normave dhe gjithçka tjetër kanë qenë masat që kemi marrë për t'i letësuar qytetart, dhe kjo tregon edhe njëherë qasjen tonë që është e kjart që është letësimi dhe zhvillim e që është ajo që e bënë bilancin pozitiv e që është të bëhen inkasimet pa e dëmtuar qytetart.

Afrim Llabjani pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që u përmend këtu testi i arritshmërisë, ai i marturës dhe dua të ndalem që duhet të përmendet kalushmeria është e ndershme edhe ai i maturës ku duhet të përmendet edhe shkollat me mbi 70% si është elena gjika ndërsa sa i përket testit të arritshmërisë, janë disa faktor, disa elemente si ajo e kurikulave e testeve dhe gjithçka tjetër.

Sa i përket infrastrukturës së shkollave su tha që janë mbi 14 vende ku janë punuar, ndërsa te qerdhet thanë asnjë qerdhe ku s'është e vërtet pasi kemi atë në Babush që o e gatshme në Greme dhe në Babush e Dardani që janë aktivizuar dhe normalisht në bashkëpunim me ministrinë jemi duke punuar pa ndal për t'i gjetur lokacionet si janë edhe Talinofc dhe vende tjera ku do të ketë nevojë për t'i vendosur, ju falemnderit.

Alberton Sahiti pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që sa i përket transportit urban ku ministria na ka dërgu një kërkesë pas punimeve në magjistrale që me ndal ose me minimizu pasi punimet po vazhdojnë andej dhe në këtë formë transporti ndërrurban edhe në takim me operatort kemi ndalur, dhe në momentin që kemi përfundimin e këtyre punimeve do të vazhdojmë me atë punë.

Meriton Hajdimi pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që sa i përket Raprotit të punës u fol edhe për projektet e Drejtorisë së infrastrukturës, desha të ndërlihem në projektet në bashkëfinancim, ku dua të theksoj që janë memorandume të mëhershme të bashkëpunimit dhe normalisht në krasaim me atë se sa ofrojmë si komunë, duhet të marrim edhe më shumë sa i përket sallës në Greme, kemi bërë ftesë disa herë nga instituciont qendrore, mirëpo s'kanë ardhë, dhe duhet ta dish që projekti i parë që është anulë është projekti prej fshatit nga vjen t'i dhe ne i kemi dërgu mbi 5 kërkesa për atë projekt por s'është përfillë.

Arbër Bytyqi pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se sa i përket projekteve të lejeve ndërtimore të kategorisë së dytë është një gabim teknik ku thuhet 18, dhe do të përmirsohet pasi jemi komuna që kemi investuar më së shumti në nivel vendi në këtë drejtim, ju falemnderit.

Kemajl Emini pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që e para QKMF ka nisur përnjëherë me Istogun e Drenasin dhe kjo s'është e vërtet pasi u nis paralelisht dhe kjo është e vërteta, (nuk dëgjohet)..

Kemi obligime me Spitalin rajonal pothuajse 20% aty kryhen, te dializa 24h i kemi shtuar edhe 5 dhoma për të adaptuar repartin e ortopedisë dhe me e rëndëshimshe është tema e stafit dhe në takim me ministrinë edhe në kuptimn e nr. banorve ne kemi dhënë dëshmi të kjarta prej 9 faqe sepse duhet të shtohet nr. ku është arsyetuar dhe p.sh. Mitrovica 65 mijë banorë, Gjakova 55 mijë dhe

Ferizaj mbi 110 mijë banor ku nr. stafit nuk është proporcional dhe kemi kërku që së paku të rritet edhe për 100 vende të lira puna, mirëpo që janë anuluar nga ministri ynë i financave.

Kryesuesi theksoi që për fund fjalën do ta merr kryetari Agim Aliu sa i përket kësaj pike dhe i cili theksoi që falemnderit të gjithë për diskutimet që patet, por besoj që është e domosdoshme të kem një fjalë pasi qytetart përfaqësuesi autentik i të cilëve jam duhet ta kuptojnë të vërteten dhe jo këto fjalë jo të vërteta. Unë pajtohem që ky raport nuk e përfaqëson gjithë punën tonë, por bindjet politike të përfaqësuar me besim qytetar nuk duhet të devijojn me ato politike, e kuptojmë taborin politik, por ndjenja e brendshme ka folur dhe kemi testuar që ata janë të knaqur me këtë qeverisje.

Ata e dinë që ne kemi aftësin për të punuar dhe besimin qytetar të konvertojmë në këto dhe askush më mirë se ata nuk mund ta besoj, as ta njeh më mirë se sa jemi të sigurtë secilin prej nesh dhe ata i kanë thënë dhe do t'i thënë sërish, se kush është i sigurt dhe kush e ka hakikat këtë punë, sepse ka kohë që është kjo simbiozë e besimit me qeverisjen.

Për hir të vërtetes dua të them disa transproti urban është sfid, e kemi pranuar si të tillë dhe përherë të parë është duke ndodhur diçka në Ferizaj, mirëpo mos harroni se vetëm 37 km më larg është Kryeqyteti Prishtina ku që disa dekada është ky diskutim, por ne e kemi nisur dhe do ta përfundojmë se si është më së miri dhe sa i përket lokacionit ai veç ka qenë i destinuar më herët me PZHK-në, e më hershme.

Transparencën veç e dhanë si përgjigje anëtarja e kuvendit, mirëpo insitituti demokratik është një organizate me kredibilitet, por faktet flasin pasi ne mund të shtyhem.

Gabi është për fushat politike për sulm politik, mirpo atë duhet ta përcillni kur përfundon një cikël një mandat dhe jo pjesërisht.

842 padi ku shumica nga këtu janë nga kontrata kolektive, të gjithë e dinë që ne s'kemi pikë faji për këtë pikë, pasi kontrata kolektive bënë këtë nr.

83 milion euro ka operuar qeveria jonë me minus pasi ato figurojnë, por si kemi patur në dispozicion ku prej tyre 23 milion janë nga kontrata kolektive.

Vetëm në Vitin 2025 kemi paguar 1,8 milion euro për një padi të Vitit 2004, nuk e them për akuzë se s'jam i tillë, mirëpo për ta thënë të vërteten për qytetarët e Komunës së Ferizajt.

Sa i përket inaugurimeve ne kemi marrë pjesë edhe kur qeveria ka patur 0 investim, për ne ska rendesi gjithmonë ku duhet të jenë ata dhe ne do të jemi aty duke respektuar përfaqesimin institucional, unë publikisht e falënderoj z.Sallahu i cili është një kryear shembull dhe eshte i vetimi projekt ai që ka sjell ky, ndërsa projektet tjera kanë një origjinë kanë një histori se kur kanë filluar.

A jemi a s'jemi model tashme ju e dini që edhe komunat tjera së bashku me kompanit e ingjinerit tonë po marrin klone nga Ferizaji dhe kjo tregon se a jemi a s'jemi model.

Duke e përmbyllur dua t'ju them qe kemi tregu vizion politik largpamësi guxim dhe ky është produkti pasi Ferizaj është shembull dhe këtë besim ata naj ridhan me 2025 dhe do të vazhdojmë të tillë, ju falemnderit.

Kryesuesi këtu dha një orë paуз për të vazhduar me rendin e ditës më pas.

Kryesuesi vazhdoi me pikën e 5 të rendit të ditës ku fjalën ia kaloi Nënkryetarit të Komunës Lulzim Aliu i cili pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që kjo su kry me kohë dhe kryetar nuk janë trajtu si legjitim dhe mbi këtë bazë nuk janë pagu, këtë pikën e njoftimit dhe shqyrtimit apo miratimit pasi ligji nuk i precizon që duhet mu miratu ky njoftim mirëpo veç duhet me kalu si i tillë si përmbledhje, megjithatë situata është këtu si është për këtë çështje pasi edhe udhëzimi dallon nga rregullorja tek nr. i kryetarëve të fshatrave, pasi rregullorja thotë; duhet te jenë 53 ndërsa udhëzimi 40 dhe këtu ka ngece kjo çështje, andaj kërkoj që nëse dikush ka diçka për të thënë le ta paraqes, mirëpo situata është kjo që është, pas diskutimit jam i gatshëm si kryetar i komisionit të përgjigjem.

Jehona Mustafa

Faleminderit i nderuar kryesues i nderuar nenkryetar të nderuar kolegë,

Si anëtare e Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave dhe bashkësive lokale, dua të theksoj se kemi qenë të angazhuar maksimalisht që ky proces të zhvillohet sa më mirë dhe sa më drejtë.

Është e vërtetë që gjatë rrugës ka pasur disa parregullsi të vogla, të cilat edhe janë bërë publike përmes mediave. Por, përkundër këtyre, procesi në tërësi ka qenë i menaxhueshëm dhe me përkushtim nga të gjithë akterët.

Ajo që personalisht nuk e kam kuptuar asnjëherë është vonesa e paarsyeshme. Kanë kaluar pothuajse dy vite që ky proces ka përfunduar dhe nuk ka ardhur në Kuvend për trajtim. Kjo nuk është në rregull dhe nuk i bën nder as institucionit tonë.

Megjithatë, mirë që më në fund është sjellë sot dhe po merr epilogun përfundimtar.

Në fund, dua të falënderoj të gjithë kryetarët e fshatrave për vullnetin dhe angazhimin e tyre, edhe në mungesë të një "drite jeshile" nga ky Kuvend. Ata kanë qenë afër qytetarëve dhe kanë kryer një rol të rëndësishëm për komunitetin.

Faleminderit.

Brahim Osmani pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që ky komision edhe unë e kam analizuar dhe përpunuar këtë proces që ka ardhur për miratim por quditrisht Drejtoria e administratës e ka pru pa marrë vendim komisioni, e dyta për dy lokalitetet lloshkobare dhe kosinë pra aryse që u ndryshu plani punës vetëm kur e pashum edhe ne si komision në ëeb faqe, e treta nëse është votu ky raport prej kujt u votu pasi deri me 30 maj jam kan unë dhe me pas ka ardhë arbnori dhe asnjë mbledhje ma sështë majt, mandati i këti komisioni ka përfundu në mandatin e kalum, drejtori i gjeodezisë në atë kohë janë kan të përfshir në këto skandale, procesi ka ndodhë me vonesë kryetari

e ka ndryshu spaku kështu kanë thanë antarit dhe në fund u thanë që u blloku nga opozita mirpo e vërteta nuk është ashtu pasi nga 7 antar vetëm 2 janë kan nga opozita dhe skem mujt.

Kur pe shohem tash thuhet që ska pas ankesa në raport kur ne 3 zona ka aps ankesa ku në mirosal surqin dhe zonën e pare ka patur, sa i përket votimit që u zhvillu sipas orarit edhe kjo o e pa vërtet pasi mrena natës janë ndrrëru disa her edhe orari edhe ndryshimet nëpër fshatra parameno asistentin e kryetarit u ba ne nerodime kryetar diku tjetër u ba drejtor i shkollës ku ska drejt pra ky raport nuk votohet pasi votat e komisionit sdo ti kishte dhe ne sdo ta votojmë kete raport falemnderit.

Edhe te pika 2 duhet te hjeket pasi që jo vetëm ne takimet publike te paguhet dhe te behen ashtu si duhet ku 6 mbledhje te kompenzohen.

Xhevat Sallahu unë deshta te lidhem ne procesin e zgjedhjes ose duhet t'i mbajmë në fillim ose në fund pasi qe s'është ne rregullë me këto komisione pasi me u mbajt disa here zgjedhje edhe per fshatin është ngarkese sa i përket pagesës per kompenzim ata kanë punë me shumë se na këtu pasi organizimi i peticionit e gjithçka tjetër është kogja e madhe edhe kërkoj qe kryetart e fshatrave te trajtohen shume me mirë dhe te respektohen, pasi janë hallka e parë e shumë problemve e sidomos në fshat.

Kryesuesi pasi s'pati tjerë për diskutimë vazhdojmë me rendin e ditës pasi pikën e 6 e kemi hjek me 21 vota për dhe 8 kunder, 0 abstenim.

Sa i përket pikës së 7 kryesuesi e lexoi si pikë të rendit dhe pyeti nëse ka dikush diçka për të shtuar dhe pasi spati të interesuar u procedua për votim dhe kaloi me 37 vota për 0.0.

Po ashtu edhe pika e 8 u hjek dhe e 9 e precizuar në procesverbal të më sipërm.

Pikën e 10 e lexoi kryesuesi dhe e drejtoresha e prezentoj si në propozim vendim kryesuesi pyeti nëse dikush ka diçka për të shtuar dhe fjalën e morri Egzona Selimi e cila pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që kjo pikë ka të bëjë me shpalljen interes i përgjithshem me qellim të këmbimit me ngastrën e cekur, mirëpo këtu kemi të bëjmë një këmbim ku një parcele e ndajmë nga toka bujqësore në tokë ndërtimore ku është bë këmbimi 1 me 1 dhe kërkoj nga drejtoresha që skica që është nda pse po votohet, e gjitha ndërsa skica u nda në qosh të rrugës, pasi sipas kësaj pronari i cili e merr këtë parcele e shfrytëzon krejt ndonse 20 ari janë marrë dhe 20 janë dhënë.

Drejtoresha theksoi që këto ngastra janë të një personi privat.

Kryesuesi pyeti kush është që të kaloj kjo pikë e rendit të ditës dhe me 21 vota për dhe 16 kundër 0 abstenim kaloi kjo pikë.

Kryesuesi e lexoi piken e 11 dhe fjalën e morri Festina Sadiku e cila theksoi që edhe kjo pikë ka të bëjë me këmbimin dhe kjo bëhet për implementimin e rrugës Varosh-Gërllicë dhe është bërë vlersimi si e keni në material.

Brahim Osmani sa i përket kësaj pike kërkoj një skjarim, nëse mundesh me kuptu këtë foto që e ke pru të njëjtën edhe drejtori i kalum kështu e ka pru dhe kjo s'është e kjartë, kërkoj që të reflektoni në këtë pjesë.

Pasi s'pati tjerë të interesuar për këtë pikë u votua dhe kaloi me 21 vota për, 16 kundër dhe 0 abstenim.

Pika e 12 është hjek dhe u vazhdua me pikën e 13 ku fjalën e morri drejtoresha e cila theksoi që ka të bëjë me një plotësim të vendimit ndryshimi do të jetë vetëm përfaqësuesi juridik do të ndryshohet vetëm subjekti pasi përfaqësuesi ka vdek dhe nuk ndryshohen kushtet apo afatet, ju falemnderit.

U votua kjo pikë me 36 vota për 0.0.

Kresuesi e lexoi pikën e 14 dhe Festina Sadiku theksoi që kjo pikë ka të bëjë me publikimin e listës pasi mapl ka kërku që të saktësohet destinimi dhe afati ndërsa pjesa tjetër mbetet me pzhk.

Sakip Haliti Faleminderit, Kryesues.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit, i nderuar Kryetar, të nderuar qytetarë, te nderuar te pranishem.

Sot para vetes kemi një Propozim - Vendim shumë të rëndësishëm – dhënien në shfrytëzim afatgjatë të 53 pronave komunale, me arsyetimin e zhvillimit ekonomik.

Në parim, ne si përfaqësues të qytetarëve nuk jemi kundër zhvillimit ekonomik. Përkundrazi, Ferizaj ka nevojë për investime, për vende pune dhe për rritje ekonomike.

Por zhvillimi nuk duhet të bëhet duke cenuar interesin publik dhe duke humbur pasuritë më të vlefshme të qytetit tone.

Ajo që na shqetëson sot me shumë është qasja se të gjitha pronat komunale ose po iepen në këmbim, ose po ipen në shfrytëzim afatgjatë – pa një analizë të thellë dhe të mirëfillt.

Pas një shqyrtimi që i kemi bërë kësaj liste, konsideroj se disa prona nuk duhet të jenë pjesë e këtij vendimi dhe duhet të hiqen nga lista.

E para, është prona me numër 188-1, afër Spitalit të ri në Talinoc të Jerlive.

Kjo si pronë mund të jetë e vogël në sipërfaqe, por është jashtëzakonisht e vlefshme – është pronë me vlerë milionëshe për shkak të lokacionit ku ndodhet. (Eshte prone e ngjitur me oborrin e Spitalit)

Kjo pronë është pasuri që duhet të ruhet për nevoja publike afatgjata. Madje, kjo pronë edhe më herët ka qenë subjekt i një tentative për këmbim, e cila ka dështuar.

E dyta, është prona me numër 180-10, te në Talinoc të Jerlive,

Pra edhe Dhënia e kësaj prone për 50 vite në shfrytëzim është e pajustificueshme. Ne nuk duhet të lejojmë që zona të tilla të kalojnë në përdorim afatgjatë privat pa një vizion të qartë nga Komuna.

E treta, është prona me numer 473-1 në Zaskok, një pronë përreth rrugës që ka qenë e destinuar për interes të përgjithshëm – si hapësira publike, fushë sportive apo çerdhe.

Kjo pronë ka pasur edhe më herët devijime dhe kundërshtime të shumta nga qytetarët. Tani, në vend që të rikthehet në funksion të komunitetit, po propozohet të jepet për shfrytëzim afatgjatë.

Gjithashtu kemi pronen me numer 188-4 që është çerdhe në oborr të spitalit të ri, kjo ngaster më e arsyeshme do të ishte të ipej spitalit se sa të ipej në shfrytëzim për 15 vite.

Ejup Delolli theksoi që kanë ardhë 2 lista dhe po pyesim për parcelën 473 në Zaskok, Ejupi theksoi që po për këtë po pyesim, drejtoresha tha është në listë të pronave për dhënie në shfrytëzim.

Më pas u hodh në votim dhe kjo pikë kaloi me 19 vota për, 16 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 15 dhe ia kaloi fjalën Drejtorit Alberton Sahiti, i cili pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që kemi të bëjmë me rregullimin e transportit publik me taksë, e cila ka kaluar të gjitha fazat dhe është punuar nga ekspert të brendshëm e të jashtëm dhe kemi një rregullore nga Viti 2004 dhe normalisht është e nevojshme të bëhet një rregullore e re, këtë që e kemi para vetës dhe me theks të veçantë do të ketë 7 kompani dhe ka pasur dëgjim publik ku ka pasur shumë interesim dhe i kemi marrë të gjitha kërkesat dhe i kemi implementuar me të rëndësishme, po ashtu një ndër to është edhe ngjyra e kaltër ku simbolizon Ferizajin, nëse kemi diçka jemi këtu për diskutim.

Sadat Ismajli pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që kjo rregullore fillimisht ka qenë propozim i imi në legjislaturën e kaluar, mirëpo në disa pika sme pelqej p.sh. të neni 6 na i kemi 5 kompani për momentin dhe cila ka qenë arsyeja që janë ba 7 ku në nenin me poshtë thuhet që nëse kemi pa, mund të bëjme me shume dhe e dyta të neni 8 1.4 flota minimum 5 dhe pse max 20 kur nëse ka kërkesë të bëhen me shume normalisht dhe të neni 9 par 1.5 ngjyrat kostot dikun kushton 800 euro dhe është barrë e madhe është ma mire me qit llogon, pasi kjo është ngarkese shumë e madhe, tu mundu me ju ndihmu po i ngarkojmë.

Hatixhe Bungu Qerimi pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që i përshëndesim këto iniciativa pom bjen me përserit me kolegun, mirëpo paska pas takim me operatorë, në jemi përfaqësues të qytetarve dhe disa nga pikat po duhet mi përsëritë, mirëpo të neni 6 pika 2 kanë kërku që të jenë 5, nëse ka kërkesa të shtohen dhe neni 8 pika 1.4 ka kërkesë që mos të kufizohen dhe normalisht i mohohet e drejta e zhvillimit ekonomik dhe pika 9 1.5 pasi kemi inflacion dhe është kosto e lartë ngjyrosja e veturave me të kaltër të qelt dhe si të tillë mund ta bejë edhe ngjyra e bardhe dhe është mirë që mos t'i ngarkojmë shumë dhe propozoj që të jetë edhe e bardha dhe llogo. Tjetër që kanë kërku është me ju leju të neni 17 pika 4 që në "Stacion të autobusëve" të lejohet me qendru normalisht.

Arian Imeri mendoj që është e mirë që po bëhet kjo rregullore dhe duhet t'i mbajmë standardet dhe jo t'i përshtatemi kërkesave të bizneseve p.sh prej 5-20 vetura flota duhet ta kuptojmë një situat ku nja biznes mund t'i bejë 100 taksë, mirëpo problemi është çka ka me ndodhë në qytet ku do t'i parkojnë dhe ju me kete do t'i eliminoni taksit individual të rregullimi i veturave duhet ta kete një standard dhe jam me kriju një standard, dhe për biznes s'janë shumë 800 euro falemnderit.

Alberton Sahiti edhe njëherë theksoi që edhe ngjyra edhe të gjitha këto janë propozime që kanë rrjedhë nga diskutimet publike dhe s'mujmë me shty këtë pikë se është me ligj me kry këtë punë.

Xhavit Zariqi thekoi që p.sh. e kemi nenin 6 me nr. e kompanive p.sh. nenin 9 ngjyra këtu propozimi është e kaltër e qelt se di kush ka thanë që ngjyra kaltër është e Ferizajt dhe neni 17 qëndrimi në “Stacion të autobusëve” kjo duhet të jetë bash aty pasi ska “Stacion të autobusëve” që ska taksi sa i përket ngjyrës edhe unë jam kundër pasi as me 800 nuk kryhet ajo punë po edhe nëse bahet o barre dhe identifikimi duhet te bahet me barre, 5 fillestare është normale që t’i ketë një kompani dhe pse t’ju kufizohet në 20 ai nëse ka punë për mu 1000 ne t’i bëjë kushtimisht pasi ska mundësi, megjithatë votimi do të jetë me shumicë pas votimit dhe e rregullojmë.(mos folni nga vendi).

Bashkim Haliti pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që unë kam propozim p.sh. te neni 7 neni 1.7 të mos jetë mardhënie pune ne këtë rast nëse ska ndalesë ligjore pse të mos jetë i licencuar për taksi, dhe një gjë tjetër është që të mos jetë penzioner, pasi nëse instruktort e autoshkollave janë diku tjetër dhe shfrytëzues të pensionit te pleqerisë pse mos te jenë taksistët d.m.th janë të diskriminuar.

Visar Azemi unë propozoj të shtyhet ky vendim për shkak që në dokumentacion kam pa shumë gjana që mund t’i rregullojmë dhe nëse shkojmë drejt digjitalizimit ka shumë për të bërë nëse shkojmë drejt eliminimit të gazrave duhet te shikohet me mire mandej ka shumë gjana këtu për ti rregullu nëse marrim me serioz këtu mungon një plan mobiliteti për vijat e qarkullimit te taksive dhe duhet te implikohen disa eksper andaj mendoj që të shtyhet ju falemnderit.

Alberton Sahiti sa ju përket 65 vjeqarve atyre ju ndalohet me ligj, dhe jemi vone me kete çështje është mirë ta miratojmë pasi edhe ashtu është e rregulluar në kuadër te ligjeve në fuqi kjo rregullore.

Kryesuesi fillimisht propozimet duhet te konstatohen kush jenë që të jetë 5 kompani dhe mbesin që starti te jetë dhe maksimum 20 kështu mbetet.

Neni 17 kush është që të qëndrojnë në stacion dhe kalon me shumicë votave që të qëndrojnë në “Stacion të autobusëve”.

Te ngjyra, a jeni që të jetë si ka qenë aty, d.m.th mbetet e kaltër e qelt.

Hatixhe Bungu kur drejtor t’i ke pas diskutim publik edhe ta kanë kërku këtë ngjyre asnjëherë ske pas as kerkush sta ka kërku.

Kryesuesi e hedh në votim që të jetë ngjyra e bardhë dhe kaltër në votim dhe kalon.

Kryesuesi e hedh në votim miratimin e rregullores me këto ndryshime që u votuan dhe kaloi me 18 vota për 0.0.

Kryesuesi te pyetje dhe kërkesa a ka ndokush diçka:

Sadat Ismajli kam disa kërkesa së pari desha ta ngris si çështje nr. 194 nr. i telefonit te urgjencës d.m.th nuk po funksionon po detyrohen qytetart të thërrosin policin e ata ta lajmrojnë, e dyta barnatort çka u ba me ato orarin, e treta hartat duhet me ju dergu “Stacionit të policisë” se po kanë problem dhe e 4 me këto konter strajt duhet të evidentohen se çka po bëhet aty, pasi të gjitha dukurit negative po bahen aty, andaj i ftoj edhe inspektort që t’i shikojnë ato.

Arbnor Murseli te rruga "Enver Topalli" ka mbet mbi nivel shaktat dhe i ftoj kompanit që ta rregullojnë atë pjesë.

Maliq Muharremi desha ta ngris si çështje për Drejtorin e Shërbimeve Publike si shqetësim urgjent të banorve të rrugës "Safet Berisha" ku rrjeti i kanalizimit është tërsisht i bllokuar dhe po bëhen dëme nëpër podrume dhe pytja konkrete se kur duhet të rregullohet, po ashtu sa ju përketë drejtorve ata duhet të qëndrojnë këtu pasi në fund të çdo rendi të ditës ne kemi pyetjet dhe kërkesat për ta.

Brahim Osmani theksoi që e kam një kërkesë edhe unë për shërbimet publike rruga prej Talinocit të Muhaxherve deri në Rahovicë kërkojë që të korrigohet kjo rrugë, pasi gjendja është tepër e keqe, deri sa te ketë një rishikim të buxhetit nga qeveria për ta rregulluar këtë rrugë.


Kryesuesi kalojmë ne te ndryhme dhe nëse ska e shpalli të mbyllur këtë seancë. Ju falemnderit.

**Procesmbajtësi**

  
\_\_\_\_\_  
**Leutrim Mahmuti**



**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

  
\_\_\_\_\_  
**Xhavit Zariqi**